



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/19/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga avokati B.N ndaj gjyqtarit J.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 11.05.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar avokati B.N, ndaj gjyqtarit J.M, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Avokati B.N me datë 20.04.2022 në Gjykatën Themelore në Prishtinë ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit J.M. Me datë 21.04.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës.

Parashtruesi ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit J.M për shkak të pretendimeve se në lëndën PPP.nr.2133/19 gjyqtari ka treguar njëanshmëri në procedim të lëndës, e cila konsiston në a) injorimin e prononcimeve përkitazi me ndryshimin/evitimin e gabimit teknik të aktit për përfaqësim dhe emërtim të Kreditorit, b) mos shqyrtimin e parashtrësive të kreditorit dhe përmbaruesit privat për tërheqjen e propozimit, c) vonesën e pajustificuar në marrjen e vendimit, d) shkeljen në masë të madhe të Kodit të Etikës. Tutje, parashtruesi ka theksuar, këto shkelje, jo vetëm që paraqesin shqetësim dhe aktualizohen nga aspekti formalo juridik procedural por është evidente se kishin për pasojë shkeljen e të drejtave elementare të paditësit/kreditorit në gjykim në një afat të arsyeshëm dhe humbjen e sigurisë juridike të realizimi i të drejtave subjektive të paditësit/kreditorit mbi bazën e një aktgjykimit të plotfuqishëm, i konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se, nuk është i saktë pretendimi që e ka injoruar gabimin teknik në aktin e përfaqësimit dhe emërimit të kreditorëve, sepse kreditori përmbarues në këtë rast nuk është pasardhës juridik i personit juridik, i cili ka pushuar së ekzistuari dhe i cili ka pasur pretendim në bazë të aktgjykimit të formës së prerë III.EK nr.196/2013 ndaj debitorit përmbarues, të cilin e ka shpjeguar me

Aktvendimin PPP.nr.2133/19, datë 22.02.2021. Tutje, gjyqtari ka theksuar se, me vendimin PPP.nr.2133/19 të datës 22.02.2021 ka vendosur sipas kundërshtimit të debitorit përmbarues ndaj urdhrin të përmbaruesit privat dhe atë ditë ka përfunduar procedura përmbarimore në këtë gjykatë, kështu që propozimi për tërheqjen e përmbarimit është bërë jolëndor sepse është dorëzuar më 26 maj 2021, pasi që ai e kishte përfunduar procedurën. Për më tepër, gjyqtari ka theksuar se, sa i përket vonesës në marrjen e vendimit, ai e ka marrë vendimin brenda afatit ligjor, por përkthimi është vonuar prandaj vendimi i është dorëzuar me vonesë kreditorit dhe debitorit.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit J.M.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit J.M lidhur me aktvendimin e marrë, për të cilat parashtruesi është ankuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese se gjyqtarit J.M ka qenë i njëanshëm në veprimet e tij gjatë procedurës në lëndën PPP.nr.2133/19 sepse nuk i ka marrë parasysht parashtruesit e kreditorit dhe përmbaruesit privat për tërheqjen e propozimit, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate, vlerëson se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë të palëve në procedurë, i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse Aktvendimi PPP.nr.2133/19 është i datës 22.02.2021 kurse parashtruesi e kreditorit për tërheqjen e propozimit është e datës 26 maj 2021, rrjedhimisht propozimi për tërheqjen e propozimit për përmbarim është bërë jo lëndor sepse është dorëzuar në gjykatë pasi ka përfunduar procedura, pra pasi është marrë aktvendimi lidhur me prapësimin e debitorit.

Sa i përket pretendimeve se, gjyqtari i çështjes është treguar i njëanshëm sepse është vonuar në marrjen e vendimit, Autoriteti Kompetent nuk ka gjetur bazë për këtë pretendim të palës, për faktin se gjyqtari i çështjes aktvendimin PPP.nr.2133/19 e ka marrë menjëherë pas mbajtjes se seancës gjyqësore të datës 22.02.2021, por vonesat në ekspedim të aktvendimit kanë ndodhur për shkak të vonesave në përkthim, dhe posa është përkthyer Aktvendimi në fjalë, i njëjti menjëherë iu është ekspeduar palëve në procedurë.

Ndërsa sa i përket pretendimeve se gjyqtari i çështjes ka injoruar gabimin teknik të aktit për përfaqësim dhe emërtim të Kreditorit, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se, kjo çështje hyn në kuadër të vendimmarrjes së gjyqtarit, dhe për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta, (të cilin pala e ka shfrytëzuar), por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/19/22, me datë 11.05.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë